



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 4
Prishtinë, më 12 prill 2011, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Mursel Haljilji, Valbona Dibra, Armend Zemaj, Afrim Hoti, Muhamet Mustafa dhe Albert Kinolli,

Mungoi: Bali Muharremaj.

I ftuar: Lars Lage OLOFSSON - auditor i përgjithshëm.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, Musa Rudaku – zyrtar i fushës së ekonomisë dhe i financave, KIPRED (staf mbështetës) - Artan Venhari e Albert Krasniqi dhe Arta Demolli – praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 29 mars 2011;
3. Diskutim me auditorin e përgjithshëm rreth prioritetëve të auditimit;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 mars 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 29 mars 2011.

3. Diskutim me auditorin e përgjithshëm rreth prioritetëve të auditimit

Kryesuesi – Në planin e publikimit të raporteve nga ZAP-i janë paraparë tri forma të auditimit: i rregullsisë, performancës dhe i menaxhimit. Kërkoj nga auditori i përgjithshëm të jepte shpjegim për këto tri lloje të raporteve. Po ashtu në mbledhjen e kaluar Komisioni i kishte ngritur disa dilema, siç ishin: auditimi i KEK-ut - pse të ketë auditim të rregullsisë e jo auditim të performancës, kur dihet se është një nga absorbuesit më të mëdhenj të buxhetit të Kosovës, si dhe mëdyshje të tjera që do t'i ngrenë anëtarët e Komisionit.

Meqenëse Kosova renditet ndër shtetet më të korruptuara, atëherë edhe përgjegjësia e këtij Komisioni është më e madhe. Interesimi më i madh është në ndërmarrjet publike ku konsumatori paguan dy herë për këto ndërmarrje, siç është KEK, sepse një herë paguan nëpërmjet buxhetit dhe një herë me fatura.

Lars Lage OLOFSSON – Plani i punës së ZAP-it besoj tashmë është përfshirë në planin e punës së Komisionit. ZAP-i e ka dorëzuar kornizën afatmesme të shpenzimeve, që do të jetë pjese e kornizës afatmesme të shpenzimeve, që Qeveria do ta paraqesë në Kuvend, në fund të prillit. Me 30 prill ZAP-i do ta dorëzojë raportin e performancës, në bazë të të cilit Komisioni do ta ketë mundësinë të mbajë llogaridhënës për të parë si e ka kryer punën ZAP-i. Janë kryer auditime shëndetësore të 34 institucioneve të pavarura, domethënë është kryer kontrolli shëndetësor i menaxhimit financiar të tyre. Janë dy auditime, që kanë filluar para dy muajve: njëri është për KQZ-në, i cili auditim nuk është kryer gjatë vjeshtës, për shkak të volumit të punëve dhe tjetri është për Ministrinë e Integritetit Europian - që është institucion i ri. Të gjitha këto do të raportohen deri në qershor. Raporti vjetor i auditimit, sipas ligjit, do të dorëzohet në fund të gushtit. Sipas ligjit ZAP-i duhet t'i kryej auditimet në bazë të standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe kjo është një sfidë e madhe. ZAP-i nuk ka burime për t'i mbuluar të gjitha auditimet. Për këtë arsye e ka paraqitur këtë formë të kontrollimit të shëndetit për të marrë njoftime dhe nëse në atë institucion ka alarme, atëherë ZAP-i fillon me auditimin e këtij institucioni. Këtë vit e kemi kryer auditimin në pesë raste dhe e kemi parë shumë të rëndësishme se institucionet buxhetore duhet të auditohen çdo vit. Kjo është masë parandaluese në vetvete. Përpos auditimeve të caktuara me ligj, ZAP-i ka të drejtë të bëjë auditime shtesë, jashtë buxhetit të Kosovës, p.sh: në ndërmarrjet shoqërore, që për pasqyrat financiare i emërojnë vetë auditorët. ZAP-i mund ta kryejë auditimin në këto ndërmarrjeve, por nuk i bën të njëjtat auditime, që i ka kryer dikush tjetër. Në disa raste, në këto institucione, që e kanë zgjedhur vetë auditorin e jashtëm, ZAP-i e bën auditimin e menaxhimit, domethënë si e kanë menaxhuar ata punën e tyre. Auditimi i performancës është mjet i ri në Kosovë. Auditimi i performancës është me shumë i përqendruar në sistem, në fushat politike, në efikasitet, në efektivitet të këtyre fushave - sistemit. Tani kemi në proces katër auditime të performancës. Sfidë është për ta gjetur fushën ku mund të kontribuohet më mirë dhe ku ZAP-i ka aftësi të bëjë diçka me vlerë për Kosovën. ZAP-i është duke planifikuar se çka do të përfshijë në planin e stinorit tjetër dhe është shumë me rëndësi për ZAP-in të marrë inpute nga Komisioni se çfarë duhet të marrë për bazë.

Kryesuesi – Pyeti se çfarë janë auditimet në proces të ZAP-it. Nëse këto auditime janë të rregullsisë, të menaxhimit apo ka edhe auditime të performancës? Këtë pyetje e shtroi duke u bazuar në atë se janë në proces rreth 80 auditime.

Afrim Hoti – Lidhur me punimet e autostradës, tha se 40%, sipas kontratës, është dashur t'u jepen firmave të vendit. Kjo nuk ka ndodhur. Kush e bën auditimin e kësaj?

Lars Lage OLOFSSON – Sipas listës do të raportohen tri auditime të performancës: *E para* ka të bëjë me menaxhimin aseteve. Kjo ka të bëjë edhe me qasjen, si janë shpalosur në pasqyra

financiare. *E dyta* ka të bëjë me subvencionet, që jepen në bujqësi. Kjo është një qasje e re si evropianët japin ndihmat financiare për zhvillimin e bujqësisë dhe *e treta* raporti i performancës ka të bëjë me atë si të raportojmë për rezultate. Kjo është një kërkesë e Ligjit për menaxhimin financave publike, që nuk është kryer kurrë. Për këtë propozojmë indikatorë të përgjithshëm si janë duke e shfrytëzuar ata buxhetin dhe jemi duke paraqitur indikatorë specifikë për secilën organizatë buxhetore, si dhe për procesin si duhet të fillojnë me përgatitjen e buxhetit. Auditimi i katërt ka të bëjë me prokurimin dhe ky nuk do të jetë gati para shtatorit. E kemi edhe auditimin e menaxhimit për importin e energjisë, në Termokos, që do ta kryejmë çdo vit. Të tjerat janë auditime të rregullsisë përveç njëres, që ka të bëjë me projektin e DANID-ës, që është për sistemin e arsimit. Ky është një projekt i veçantë që financohet nga danezët. Këtë jemi duke e kryer në bazë të një kontrate dyvjeçare dhe për të kemi kërkesë edhe nga Banka Botërore. Ideja është si po vijnë mjetet në Kosovë dhe si kryhet menaxhimi financiar i tyre.

Lidhur me pyetjen për autostradën tha se është një shembull i mirë për prioritetet e ZAP-it, për stinorin tjetër të auditimeve. Një prej prioritetëve është edhe auditmi i partneritetit publiko-privat. Ajo çka duhet të bëjë ZAP-i është të analizojë sa po i përmbahen kontratës për 20 apo 30 vjet, sepse kjo shkon në interes të vendit. Duhet të kemi qasje për këtë.

Ramiz Lladrovci – Qeveria ka bërë kontratë me firmën “Benkel Enka” për ndërtimin e rrugës Morinë – Merdare. Në kontratë është e detyruar që 40% e punës t’i jepet firmave vendore. A keni të drejtë ta auditoni firmën “Benkel Enka” për këtë gjë?

Muhamet Mustafa – Ne po ballafaqohemi me një perceptim në rritje lidhur me korrupsionin në Kosovë, që e ka burimin pikërisht në përdorimin e parasë publike. Qytetarët janë të brengosur si po shpenzohet paraja publike. Në këtë drejtim prijnë: ndërmarrjet publike, administrata qendrore dhe ajo lokale. Këtu kemi harxhues të mëdhenj. Ajo që konstatohet edhe në Raportin e progresit - prokurimi është problemi qendror. Rreth 80% e buxhetit shpenzohet në shëndetësi, transport, infrastrukturë, arsim dhe mirëqenie sociale. Pra, problemi kryesor është në këto katër shtylla dhe në këto katër shtylla Komisioni duhet të bashkëpunojë me ZAP-in, në mënyrë që të përmirësohet performanca në menaxhimin e parasë publike. Nuk duhet të përqendrohemi në prezantim teknik, por duhet të shikohen kontratat e prokurimit, a janë të prekshme shërbimet për paranë e shpenzuar.

Murselj Haljilji – Në strukturën e punësimit në ZAP, sa janë përfshirë minoritetet? A keni projekt sa do të punësohen në të ardhmen në këtë zyrë nga minoritetet? Sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve në f. 4, thuhet: *“Ne do të fillojmë me fondacionin e donatorëve, duke ua hapur rrugën marrëdhënieve të reja financiare ndërmjet Kosovës dhe komunitetit të donatorëve”*. Çka nënkuptoni me këtë, kur thuhet se do të filloni? A do të thotë se kjo nuk ka ekzistuar më parë dhe pse bëhet kjo kur e kemi parasysh se ZAP-i ka ngarkesë dhe nuk ka staf të mjaftueshëm për t’i mbuluar të gjitha auditimet si p.sh kuvendet komunale?

Valbona Dibra – E ndau mendimin me deputetin Muhamet Mustafa. Shtoi se ZAP-i duhet t’i shtojë auditimet e performancës, sepse këto auditime e paraqesin një realitet më të mirë të shfrytëzimit të parasë publike. Si të kenë efekt raportet e auditimit? Raporti duhet të shkojë në gjykatë. Dikush duhet të dënohet për keqmenaxhim. Çka ka bërë ZAP-i në këtë drejtim në mënyrë që të shtyhet procesi tutje?

Armend Zemaj – ZAP-i i ka ngritur kapacitetet dhe ka filluar edhe me auditime të tjera. Kjo e mundëson një kontrollim të vërtetë të parasë publike. Komisioni do ta shqyrtojë edhe raportin e performancës së ZAP-it, për ta rritur pastaj besueshmërinë në këtë zyrë, se dikush e kontrollon shpenzimin e parasë publike. Nga raportet, në publik, po krijohet përshtypja se gjithçka është në rregull, ndërsa në këto institucione largohen njerëz nga puna ose edhe ndiqen penalisht. Kemi raste kur brenda organizatave buxhetore njerëzit, që punojnë me kontratë, për një zhvillim strategjie paguhen si kuadër deficitar dhe deri më sot kjo nuk është pasqyruar në raportet e auditimit. Bashkëpunimi është i domosdoshëm. Komisioni do ta përkrahë ZAP-in në mënyrë që ta mbikëqyrë shpenzimin e parasë publike, e pse jo edhe të donacioneve.

Albert Kinolli – A i ka identifikuar ZAP-i çështjet se çka duhet të ndryshohet në kornizën ligjore? Sipas objektivave të ZAP-it për vitin 2011 - 2012 ndërhyrjet në këtë kornizë ligjore janë shtyrë si pasojë e situatës politike. A mund të ndodhë që kjo kornizë ligjore nuk do të ndryshojë, duke u nisur nga fakti se politikës asnjëherë nuk i dihet?

Lars Lage OLOFSSON – ZAP-i duhet ta përcjellë shpenzimin e çdo centi publik, por definitivisht nuk mund t'i auditojë dy firma. ZAP-i mund ta auditojë projektin, ku shteti ka interes, p.sh. si i përmbahet projekti marrëveshjes. Për këtë duhet të kemi qasje, por se kur do të ndodhë kjo nuk e dimë.

Lidhur me kornizën ligjore tha se ZAP-i e ka identifikuar nevojën e ndryshimeve. Nevoja është për një ligj krejtësisht të ri. ZAP-i parasheh që në vjeshtë kjo çështje të ngrihet edhe në Kuvend. Për auditor të performancës ZAP-it i duhen auditorë me shkathtësi analitike. Për disa fusha ZAP-i ka auditorë me mundësi të mira analitike, e për disa të tjera jo. Të gjitha raportet e ZAP-it janë publike. Prokurorët dhe gjykatat mund t'i lexojnë, por kjo nuk mjafton. ZAP ka marrëveshje me Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe me EULEX-in. Në momentin që vërehen mashtrime, ZAP-i e ka të ashtuquajturin "*flamur të kuq*" dhe e përgatit lëndën që e dërgon në prokurori, me udhëzime ku dhe çka të shikohet. Nuk ka shumë raste që i janë nënshtruar sistemit të drejtësisë, por ka shume raste që janë ndëshkuar për krime financiare. Masat administrative merren shumë rrallë, kur zbulohet se në punën e dikujt diçka nuk ka shkuar në rregull. Minoritetet në ZAP janë sfida e madhe. ZAP-i po përpiket, por nuk është shumë i suksesshëm në këtë drejtim. Në ZAP punojnë katër serbë dhe një goran. Pse auditohen donacionet? ZAP fiton para për këtë punë. Kjo është në interes të Kosovës, sepse ka kontroll më të mirë të fondeve që hyjnë në Kosovë. Kjo është edhe në interes të Bankës Botërore, sepse mund të mbështetet në sistemin financiar të Kosovës, është edhe në interesin e BE-së sepse mund të kalojë prej kësaj faze në fazën e paraanëtarësimit të fondeve. Para kësaj duhet të binden se këto fonde janë nën kontroll dhe këto fonde duhet të auditohen.

Kryesuesi – Kapacitetet e ZAP-it janë të kufizuara për t'i përfshirë të gjitha adutimet dhe ZAP-i duhet ta ketë parasysh se prioritet është paraja publike.

Muhamet Mustafa – Si është qasja e ZAP-it, në katër shtyllat e përmendura, përfshirë këtu edhe ndërmarrjet publike? Për çështjet ku ZAP-i nuk mund të ndërhyjë, atëherë është çështje e Komisionit si të veprojë.

Ramiz Lladrovci – Meqenëse ZAP-i ka e filluar auditimin e një donacioni të jashtëm, ai raport a do t'i procedohet këtij Komisioni?

Lars Lage OLOFSSON - Prioriteti i ZAP-it nuk është auditimi i projekteve dhe i donacioneve dhe ZAP-i nuk i merr përsipër punët që nuk do të mund t'i kryejë.

Auditimet që i bën ZAP-i janë të caktuara me ligj. Në listën e raporteve është paraparë edhe raporti që e kemi bërë për DANID-ën dhe ju mund ta analizoni nëse keni dëshirë. U pajtua me atë që janë tri shtylla kryesore. ZAP-i duhet të shohë ku janë fondet më të mëdha dhe ku është interesi më i madh publik. Por, në këtë kohë po auditohen edhe institucionet më të vogla, që kanë ndikim në institucionet e mëdha.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu